

Zhillohet sesion informues mbi projektin “Harvard Simulation Days” në bashkëpunim me Protik Innovation Hub

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Protik Innovation Hub, organizoi një sesion informues mbi projektin “Harvard Simulations Days.” Ky projekt, i zhvilluar në partneritet me Ambasadën Amerikane dhe Harvard Business Publishing, përfshin një seri simulimesh që mbulojnë tematika si siguria kibernetike, sipërmarrja dhe startup-et.

Në workshop-in e mbajtur në Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, morën pjesë 19 studentë nga programet e Teknologjisë së Informacionit, Matematikë-Fizikë, Punë Sociale dhe Infermieri e Përgjithshme. Studentët shfaqën interes për aktivitetin, i cili do të kulmojë në Tiranë me një simulim të madh, ku studentë të përzgjedhur nga universitetet e Shqipërisë do të sfidojnë njëri-tjetrin në një mjedis konkurrues dhe bashkëpunues.

Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të bashkëpunojnë me ekspertë ndërkombëtarë dhe përfaqësues nga kompani të ndryshme shqiptare. Projekti do të përfundojë me një aktivitet “Meetup and Networking Day,” i cili do të fokusohet në përmirësimin e aftësive prezantuese të studentëve.



